**Raport mbi shperndarjen e Aksioneve per Shoqerine:** **Data 23.04.1997**

**"FABRIKA E ÇIMENTOS" ELBASAN**

Numri i Autorizimit 594 Data 10 Mars 1997
Rrethi: TIRANE

**EMRI MBIEMRI**
**"SEAMENT ALBANIA"Shpk perfaqesuar nga Mark BOURI**

Leke: 600.000.000

Vlera Nominale e Aksionit: 1000

Numri i Aksioneve: 485.100

Numri i Pasaportes: B 468072

Perqindja ne kapitalin e ndermarrjes 70%

***Adresa*** :
Bulevardi Deshmoret e Kombit, Nr. 72
**TIRANE**

**Protokoll i Llogaritjes per ankandin**

**Agjencia Kombetare e Privatizimit**

**Data 23.04.1997**

Emri i Shoqerise Aksionere

**"FABRIKA E ÇIMENTOS" ELBASAN**

| | | |
|---|---|---|
| Kapitali themeltar | 100% | 693.000.000Leke |
| Pjesa e kapitalit qe shitet | 70% | 485.100.000Leke |
| Vlera nominale e nje aksioni | | 1000 leke |
| Vlera totale e ankandit | | 600.000.000leke |
| Vlera e aksionit te vendosur nga ankandi | | 1236,858379 leke |
| Numri i aksioneve te shitura | | 485.100 |
| Numri i aksionereve | | 1 |
| Numri i Aksioneve qe mban Shteti | | 207.900 |
| Koeficienti i shitjes *(Raporti i vleres se Aksionit e vendosur nga Ankandi me vleren nominale te Aksionit)* | | 1,2368583 |

**DREJTORE E PERGJITHSHME**

**LINDITA XHILLARI**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E PRIVATIZIMEVE**
**Drejtoria e Shoqerive Publike**
**Nr 30 Prot** **Tirane me 9.1.1997**

**URDHER**
**Nr 11 date 9.1.1997**

**PER**
**TRANSFERIMIN E AKSIONEVE NE SHOQERINE ANONIME "FABRIKA E CIMENTOS" ELBASAN**

Ne baze te nenit 1 te Dekretit nr 1631 date 1.11.1996, miratuar me Ligjin nr 8158 date 7.11.1996 "Per miratimin me ndryshime te dekretit nr 1631 date 1.11.1996, Per disa ndryshime ne ligjin 7926 date 20.04.1995, Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare, ndryshuar me dekretin nr 1195 date 14.08.1995 dhe ligjin nr 8099 date 28.03.1996" me cilesine e aksionerit te vetem,

**Urdheroj:**

**1.**Te privatizohet nepermjet transferimit te aksioneve shoqeria anonime "Fabrika e cimentos" Elbasan, sipas Vendimit nr 837 date 09.12.1996 te Keshillit te Ministrave.

**2.**Transferimi i aksioneve te behet ne masen 70 %.

**3.**Transferimi i aksioneve ne perputhje me piken 2 te ketij urdhri te perfundoje brenda afateve ligjore ne fuqi.

**MINISTRI**
**Dylber VRIONI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E PRIVATIZIMEVE TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit

Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Mesme e te Vogla

URDHER

Nr. 31 Date 27.8.1999

PER

**TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TE SHOQERISE ANONIME "ELBASAN CEMENT FAKTORY" ELBASAN**

Ne baze nenit 2 te Ligjit Nr.8237 date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926 date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" me cilesine e zoteruesit te 30% aksioneve te shoqerise, te Ligjit Nr.8334 date 23.04.1998 "Per privatizimi e shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjik", te V.K.M. Nr.446 date 09.07.1998 "Per procedurat e privatizimit me ankand te paketave shteterore te aksioneve te shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjik" te V.K.M. Nr 24 date 21.1.1999 "Per nje shtese ne V.K.M. Nr 446 date 9.7 1998 ....,V.K.M. Nr 328 date 12.07.1999"Per disa ndryshime ne V.K.M. Nr 446 date 9.7.1998 ... dhe te nenit nr 11 te statutit te "Elbasan Cement Faktory "sh.a.

*Urdheroj:*

1-Te transferohen aksionet ne masen 7 % , me vlere 48.510. 000 leke nga paketa e aksioneve te zoteruara nga shteti ne shoqerine anonime "Elbasan Cement Faktory" e cila I ofrohet ortakut pa ankand ne leke , sipas V.K.M. Nr 24 date 21.1..1999.

2-Transferimi I aksioneve sipas pikes 1 te ketij urdheri te perfundoj brenda afateve ligjore ne fuqi.

3-Urdheri Nr 13 date 14.10.1998 shfuqizohet.

REP. SHQIPERISE DHOMA NOTEREVE TIRANE VERT. FOTOKOPJA E NJEJTE ME ORIGJINALIN N PARAQIT

NOTERE MIMOZA SHEHU

MINISTRI
YLLI BUFI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTER HALIM ISLAMI
Nr. 34 ........Regj. Nr. 133 Kol

Tirane, 09.11.1999

# KONTRATE
# PER SHITJEN (TRANSFERIMIN) E 7 %(SHTATE PERQIND) TE AKSIONEVE NGA AKSIONET QE SHTETI SHQIPTAR ZOTERON NE "ELBASAN CEMENT FACTORY"SH.A., ELBASAN

Sot, me date 09 Nentor 1999 (njemije e nenteqind e nentedhjete e nente), diten e Marte ora 14:45 ne Agjensine Kombetare te Privatizimit Tirane, perpara meje noterit Halim Islami, i Dhomes se Noterise Tirane u paraqiten palet dhe ne prezence te tyre hartohet kontrata e shitjes (transferimit) te 7 % (shtate perqind) te aksioneve te zoteruara nga Shteti Shqiptar ne "Elbasan Cement Factory"Sh.a,

te cilat rane dakord per sa vijon :

**Neni 1 - Palet**

1.1 *Pala shitese:* Agjensia Kombetare e Privatizmit Tirane e perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem i saj, Z. Qirjako Theodhori.

1.2 *Pala blerese:* "Seament Albania"Sh.p.k.. e njohur person juridik me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr.6446, date 23.9.1994, perfaqesuar nga Z.Jorge Joha,lindur ne Brazil me 15.05.1953 me nr pasaporte CJ 639476, me banim ne Tirane, sipas prokures se Noterise Nr.7303 Rep.e Nr.2546 kol..date 30.10.1999.

Neni 2 - Objekti i kontrates

2.1 Objekt i kesaj kontrate eshte shitja (transferimi) e 7 % (shtate perqind) te aksioneve te zoteruara nga shteti ne "Elbasan Cement Factory" Sh.a, me vlere 48.510.000 leke (dyzetete miljon e peseqind e dhjete mije), referuar kapitalit themeltar te shoqerise ne momentin e regjistrimit ne Gjykaten e Rrethit Tirane me vendimin Nr.15167 date 13.06.1996 te pasqyruar edhe ne Akt themelimin dhe Statutin e Shoqerise me vlere 693.000.000 leke (gjashteqind e nentedhjete e tre miljon ) me 693.000 aksione me vlere nominale 1000 leke, kapital sipas vleresimit me dokumentin bilanci ushtrimor financiar i vitit 1995 i specifikuar: a) shuma e ndertesave me vlere 419.577.379 leke dhe b) vlera e truallit sip. 133.000 m2 sipas genplaneve dhe aktvleresimit ,vertetimit Nr.1173 date 16.11.1995 me vlere 42.560.000 leke.

## Neni 3 - Cmimi i shitjes

3.1 Cmimi i shitjes se 7 % (shtate perqind) te aksioneve te zoteruara nga shteti. ne shoqerine "Elbasan Cement Factory" Sh.a. ortakut "Seament Albania" Sh.p.k. eshte 48.510.000 leke (dyzet e tete miljon e peseqind e dhjete mije). vlere e paguar plotesisht nga pala blerese ne Banken e Kursimeve, Dega Tirane, numri i llogarise 4302 (Dega e Thesarit) ne favor te Agjensise Kombetare te Privatizmit.

3.2 Pala shitese deklaron se ne favor te saj eshte derdhur e gjithe shuma e percaktuar ne piken 3.1 te ketij neni para perpilimit te kesaj kontrate sipas urdherxhirimit i jashtem leshuar nga Banka e Kursimeve Tirane me nr.<u>609762</u> date <u>09.11.1999</u> per shumen <u>14.550.000</u> leke (katermbedhjete miljon e peseqind e pesedhjete mije), mandatarketimit leshuar nga Banka e Kursimeve Tirane me nr.1145617 date 03.11.1999 per shumen 3500 leke (tremije e peseqind) dhe nr.<u>609761</u> dt.,<u>09.11.1999</u> per shumen <u>33.958.000</u> ( <u>tridhjete e tre milionenendeqintepesedhjete e tete mije)</u>leke. Vlefta totale e paguar nga pala blerese eshte <u>48.510.000 leke (dyzete tetemiljon e pesqind e dhjete mije</u> )leke.

## Neni 4 - Kushtet e shitjes

4.1 Aksionet prej 7 % te zoteruara nga shteti qe shiten jane pershkruar ne perputhje me dokumentacionin derguar Agjensise Kombetare te Privatizmit nga Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit me shkresat Nr 5526/2 Prot, date09.09.1999,Nr.5526/3 Prot., date21.09.1999, Nr.5526/6 Prot., date 12.10.1999, Nr.6862/1 Prot., date 26.10.1999 dhe Nr.7021 Prot.,date 29.10.1999 perpara perpilimit te kesaj kontrate.

4.2 Pala blerese ka pletesuar te gjitha kushtet e percaktuara nga pala shitese ne autorizimin Nr.3191 Prot. date 01.11.1999(njemije e nenteqind e nentedhjete e nente) te Agjencise Kombetare te Privatizimit Tirane.

4.3 Pala blerese pas nenshkrimit te kesaj kontrate, noterimit te saj dhe pas regjistrimit te aksioneve ne Qendren e Regjistrimit te Aksioneve, eshte pergjegjese per te gjitha detyrimet ligjore ndaj shtetit qe mund te lindin ne lidhje me keto aksione qe nga momenti i firmosjes se kesaj kontrate.

4.4 Pala shitese garanton palen blerese per pronesine shteterore te 7 % te aksioneve objekt i kesaj kontrate , dhe se ato jane te lira nga cdo detyrim apo barre ligjore dhe pretendim i cdo personi te trete.

Pas firmosjes se kesaj kontrate dhe noterimit te saj, pronesia e 7 % (shtate perqind) te aksioneve transferohet nga ortaku shteteror tek ortaku "Seament Albania"Sh.p.k., ne perputhje me objektin e kesaj kontrate.

## Neni 5 - Te drejtat dhe detyrimet e Bleresit

5.1 Bleresi pranon blerjen e 7 % te aksioneve te zoteruar nga shteti Shqiptar ne "Elbasan Cement Factory" Sh.a me kerkesen drejtuar Agjencise Kombetare te Privatizimit date 29 Tetor 1999 nga "Seament Albania"Sh.p.k.

5.2 Bleresi fiton te drejten e pronesise mbi 7 % (shtate perqind) te aksioneve te blera prej tij, pas firmosjes se kesaj kontrate ne perputhje me legjislacionin perkates.

5.3 Bleresi eshte pergjegjes per te mbuluar te gjitha shpenzimet ligjore dhe te noterise ne lidhje me rregjistrimin e ketyre aksioneve.

5.4 Bleresi eshte pergjegjes per transferimin e titullit te pronesise ne emer te vet.

5.5 Shoqeria "Seament Albania" Sh.p.k. merr persiper detyrimin per zbatimin e akt marreveshjes se lidhur ndermjet Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit dhe "Elbasan Cement Factory" Sh.A. date 06.10.1999

5.6 Pas nenshkrimit te kesaj kontrate, brenda 30-diteve, ne baze te ligjit Nr. 7843, date 13.07.1994 "Per Regjistrimin e Pasurive te Paluajteshme", pala blerese eshte e detyruar te paraqitet ne Qendren e Regjistrimit te Aksioneve.

5.7 Pala blerese pas nenshkrimit, noterizimit te kesaj kontrate dhe rregjistrimit ne Zyren e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Elbasan dhe ne Qendren e Regjistrimit te Aksioneve Tirane behet pronar i 7 % (shtate perqind) te aksioneve, objekt i kesaj kontrate,ne "Elbasan Cement Factory" Sh.a., me seli ne Tirane me adrese :Bulevardi "Deshmoret e Kombit" Nr.72.

**Neni 6 Te drejtat dhe detyrimet e shitesit.**

6.1 Pala shitese garanton bleresin per pronesine e plote dhe te ligjshme te shtetit mbi 7% ( shtate perqind ) te aksioneve te Sh.A. " Elbasan Cement Factory" te ofruara pales blerese.

6.2 Pala shitese garanton palen blerese per perputhjen e kesaj kontrate me frymen e legjislacionit civil ne Republiken e Shqiperise, si dhe te drejtat ligjore te bleresit ne lidhje me pronesine objekt i kesaj kontrate, perballe organeve gjyqesore, ne rast kontestimi te kontrates , kur kjo i kerkohet nga pala blerese.

Neni 7- <u>Baza ligjore per lidhjen e kontrates</u>

- Kodi Civil i Republikes se Shqiperise;
- Ligji Nr. 7512, date 10.08.1991;
- Ligji Nr. 7638, date 19.11.1992;
- Ligji Nr.8237,date 01.09.1997,
- Ligji Nr.8334, date 23.04.1998
- VKM Nr. 416, date 09.07.1999;
- VKM Nr. 24, date 21.01.1999,
- VKM.Nr.328, date 12.07.1999,
- Udhezimi Nr. 21, date 16.06.1998;
- Udhezimi Nr. 2, date 28.10.1999,
- Statuti i "Elbasan Cement Factory"Sh.a.
- Akt themelimi i "Elbasan Cement Factory"Sh.a.
- Aktmarreveshja e dates 06.10.1999 midis MEPP-se dhe "Elbasan Cement Factory"Sh.a.
- Urdheri i MEPP-se Nr.31, date 27.08.1999.

Neni 8 - <u>Dokumentat ligjore qe i bashkengjiten kesaj kontrate</u>

8.1.Urdheri Nr.31 date 27.08.1999 i Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit me nje flete,(fotokopje e noterizuar);

8.2.Shkresa e Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit Nr.5526/2 Prot., date 09.09.1999 me nje flete. (fotokopje e noterizuar).

8.3.Statuti i "Elbasan Cement Factory"Sh.a., me nente flete (fotokopje e noteuar) i vertetuar nga Dhoma e Notereve Tirane Nr.579 Rep., Nr.197 kol., date 27.06.1999 me nje flete (fotokopje e noterizuar).

8.4.Shkresa e Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit Nr.5526 Prot., date 26.08.1999 me nje flete.(fotokopje e noterizuar). Letra e "Elbasan Cement Factory"Sh.a., drejtuar Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit date 26.08.1999 me nje flete fotokopje e noterizuar.

8.5.Shkresa e Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit Nr.5526/3.Prot., date 21.09.1999 me nje flete fotokopje e noterizuar.

8.6.Akt marreveshje e dates 06.10.1999 midis Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit dhe "Elbasan Cement Factory"Sh.a.,me nje flete fotokopje e noterizuar.

8.7.Shkresa e Ministrise se Ekonomise publike dhe Privatizimit Nr.7021.Prot., date 29.10.1999 me nje flete fotokopje e noterizuar.

8.8.Shkresa e Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit Nr.6862/1 Prot., date 26.10.1999 me nje flete fotokopje e noterizuar.

8.9.Shkresa e Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit Nr.7145 Prot., date 08.11.1999 me shtate flete fotokopje e noteruar.

**Neni 9 – Te ndryshme**

9.1.Kjo kontrate iu lexua gojarisht paleve. Kjo kontrate perbehet nga 4 faqe, me kerkesen e paleve perpilohet ne 4 (kater) ekzemplare ne gjuhen shqipe. Nje kopje e kontrates qendron ne Zyren e Noteres, nje kopje ne arshiven e Agjensise Kombetare te Privatizimit. dhe 2 (dy) kopje pales blerese.

9.2.Pala shitese pasi e kuptoi permbajtjen e gjeti sipas vullnetit te tij te lire e te plote, po keshtu pala blerese pasi e kuptoi permbajtjen e gjeti sipas vullnetit te tij te lire e te plote. Ne kete [illegible] e nenshkruan kontraten ne prani te noterit pa asnje [illegible]. Une noteri ne [illegible] ligjit Nr.7829, date 01.06.1994 "Per Noterine" si dhe legjislacionit perkates per [illegible] e aksioneve ne shoqerite anonime e vertetoj ate sipas ligjit.

*PALET KONTRAKTUESE*

*PALA SHITESE*

Agjencia Kombetare e Privatizimit

Qirjako Theodhori

Drejtor i Pergjithshem

*PALA BLERESE*

"SEAMENT ALBANIA "Sh.p.k.

perfaqesuar nga

Jorge Jeha

**VENDIM**

Mbledhja e Jashtezakoneshme e Asamblese se Aksionereve te shoqerise "Elbasan Cement Factory" Sh.A. me unanimitet miraton shitjen e 7% te aksioneve te zoteruara nga Shteti Shqiptar ne favor te aksionerit tjeter shoqerise "Seament Albania" Shpk.

Merret ne shqyrtim pika e dyte e rendit te dites.

Meqenese aksioneri "Seament Albania" Shpk blen 7% te aksioneve te zoteruara nga Shteti Shqiptar, detyrimisht statuti i shoqerise "Elbasan Cement Factory" SH.A. peson ndryshime dhe konkretisht ne nenin 6 paragrafi i dyte dhe i trete, pasi ndryshojne perqindjet dhe numrat e aksioneve te zoteruara nga sejcili aksioner. Mbas diskutimit te ketyre ndryshimeve Asambleja miraton ndryshimet e propozuara.

**VENDIM**

Mbledhja e Jashtezakoneshme e Asamblese se Aksionereve te shoqerise "Elbasan Cement Factory" Sh.A. me unanimitet miraton ndryshimin e nenit 6 te statutit, paragrafi i dyte dhe i trete i te cilit behen:

- "Aksionet me numer nga 1 deri ne 533,610 te cilat perfaqesojne 77% (shtatedhjeteshtate perqind) te aksioneve te shoqerise zoterohen nga shoqeria "Seament Albania" Sh.p.k., dhe
- "Aksionet me numer nga 533,611 deri ne 693,000 te cilat perfaqesojne 23% (njezetetre perqind) te aksioneve te shoqerise zoterohen nga Shteti Shqiptar."

Meqenese nuk ka gje tjeter per te diskutuar kryesuesi mbyll Mbledhjen e Jashtezakoneshme te Asamblese se Aksionerve.

Tirane, me date 9.11.1999

Mark Bouri
Kryesuesi i Mbledhjes se
Jashtezakoneshme te Asamblese

Vojo Malo
Sekretar dhe mbajtes i
proces verbalit

# REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E EKONOMISE PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT

DREJTORIA E PRIVATIZIMIT TE NDERMARRJEVE E SHOQERIVE TE VOGLA DHE TE MESME

**Blvd. Deshmoret e Kombit Nr.2**
**E-mail: postmaster@mepp.tirana.al**
**Internet:HTTP://WWW.MEPP.GOV.AL**

**Tel: 355 - 42 6795**
**Fax: 355 - 42 25154**

Nr. _____ Prot.

Tirane, me .............2001

**URDHER**
**Nr 50 3 date 22.10 2001**

**PER**

**TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TE SHOQERISE ANONIME "ELBASAN CEMENT FACTORY" ELBASAN**

Ne baze te nenit 2 te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" ndryshuar me akte te tjera ligjore, ligjit Nr.8334 date 23.4.1998 "Per privatizimin e shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjike",dhe ne zbatim te vendimit Nr.119 date 18.3.2000 te Keshillit te Ministrave "Per procedurat e privatizimit me ankand te paketave shteterore te aksioneve te shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjike" , me cilesine e zoteruesit te aksioneve te shoqerise :

*Urdheroj :*

1-Te transferohet paketa e aksioneve per ish pronaret e truallit te shoqerise anonime "Elbasan Cement Factory" Elbasan, ne masen 3,3759307359 % te kapitalit te shoqerise te regjistruar ne Gjykate, me vlere 23.395.200 leke, qe i pergjigjet numrit te aksioneve nga 1-23 395,2.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

**MINISTRI**

**Mustafa MUCI**

TIRANE

# REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E EKONOMISE PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT

DREJTORIA E PRIVATIZIMIT TE NDERMARRJEVE E SHOQERIVE TE VOGLA DHE TE MESME

Blvd. Deshmoret e Kombit Nr.2
E-mail: postmaster@mepp.tirana.al
Internet: HTTP://WWW.MEPP.GOV.AL

Tel: 355 - 42 26795
Fax: 355 - 42 25154

Nr. _____ Prot.

Tirane, me .............2001

**URDHER**

**Nr. 503/1 date 15.11. 2001**

**PER**

**TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TE SHOQERISE ANONIME "ELBASAN CEMENT FACTORY " ELBASAN**

Ne baze te nenit 2 te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" ndryshuar me akte te tjera ligjore, ligjit Nr.8334 date 23.4.1998 "Per privatizimin e shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjike",dhe ne zbatim te vendimit Nr.119 date 18.3.2000 te Keshillit te Ministrave "Per procedurat e privatizimit me ankand te paketave shteterore te aksioneve te shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjike" , me cilesine e zoteruesit te aksioneve te shoqerise :

*Urdheroj :*

1-Te transferohet paketa e aksioneve per ish pronaret e truallit te shoqerise anonime "Elbasan Cement Factory" sh.a Elbasan, ne masen 0,415584415 % te kapitalit te shoqerise te regjistruar ne Gjykate, me vlere 2.880.000 leke, qe i pergjigjet numrit te aksioneve nga 1-2.880.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT TIRANE

MINISTRI

Mustafa MUCI

MINISTRI...

PROT NR 7671, 26.11.2001
DREJT Genci
NR DOSJES ........

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
KESHILLI I MINISTRAVE
AGJENCIA KOMBETARE E PRIVATIZIMIT

Nr 3251 Prot.

Tirane, me 21.11 2001

*Lenda* : Dergohen rezultatet perfundimtare te llogaritjeve per paketen e aksioneve per ish pronaret e truallit te shoqerise "Elbasan Cement Factory" Sh.a. Elbasan.

**MINISTRISE SE EKONOMISE PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT**

**Drejtorise se Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla dhe te Mesme**

**TIRANE**

Ne zbatim te VKM. Nr.119 date 18.03.2000, Kapitulli III, pika 1 si edhe te Urdherit te Ministrit te Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit Nr.503/1, date 15.11.2001, po ju dergojme rezultatet perfundimtare te llogaritjeve per paketen e aksioneve per ish pronaret e truallit te shoqerise "Elbasan Cement Factory" Sh.a Elbasan.

Bashkelidhur keni, Protokollin perfundimtar te llogaritjeve per perqindjet qe ze paketa e aksioneve te ish pronareve te truallit te kesaj shoqerie ne kapitalin themeltar me nje flete si edhe llogaritjet analitike per çdo aksioner me nje flete.

Kozeta FINO

Drejtor i Pergjithshem

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT TIRANE SEKRETARIA

## NDERMARRJET, VLERA E TRUALLIT DHE PJESA E PRONAREVE TE TRUALLIT

| | Kapitali Themeltar | Vlera e Truallit | Pjesa e Pronareve te Truallit | Numri i Aksioneve |
|---|---|---|---|---|
| Elbasan Cement Factory Sh.A Elbasan | 693'000'000,00 | 2'880'000,00 | 0,41558441 56% | 2880 |
| Furnizim Ndertimi Nr2 Sh.A Durres | 44'950'000,00 | 1'438'890,00 | 3,2010901001% | 1438,89 |